

Data 31.08.2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

BLERJE SET URGJENCE

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
33140000-3

VLERA E FONDIT LIMIT:

**13.120.500 (trembëdhjetë milionë e njëqind e njëzet mijë e pesëqind) leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Kombetare e Urgjences Mjekesore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e ofertës sipas Shtojcës 1*

*b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. i ndryshuar.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

.....  
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. - Xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit duhet të ketë një vlerë sa vlera e fondit limit. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne nenin 73 të VKM nr.285 parashikohet:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

-vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

---

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM nr.285, neni 43, pika 1:

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi **deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate *(apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri konsiderohet i përmbushur për kontratat e ngjashme të realizuara gjatë 3 viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 *(ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b)*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 40, pika 4 të VKM Nr.285:

*Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Kjo vlerë është vendosur për të krijuar bindjen të AK se OE fitues është në gjendje të realizojë me sukses kontratën, duke qenë se edhe objekti i prokurimit është i një rëndësie jetike (blerje sete urgjence)*

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.2.** Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim për këtë procedurë prokurimi nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku në rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregtimit të artikujve. (të perkthyer dhe të noterizuar).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Ne zbatim të nenit 40 të VKM nr.285, pika 8:

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ky kriter është vendosur për të vërtetuar se OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, është i autorizuar për tregtimin e këtyre mallrave (në rast se nuk është vetë prodhues), pasi kjo garanton cilësinë e mallrave dhe seriozitetin/garancinë se OE do të realizojë me sukses kontratën me AK.

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenit 21 të ligjit nr.89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ne nenin 21 të ligjit nr.89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, parashikohet:

*Autorizimi për tregtim të pajisjeve mjekësore*

*1. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse, pajis me autorizimin për tregtim prodhuesit, vendas ose të huaj, që kanë regjistruar biznesin në Shqipëri, dhe tregtuesit me shumicë e tregtuesit me pakicë të pajisjeve mjekësore. 2. Rregullat për pajisjen me autorizimin për tregtim të pajisjeve mjekësore dhe për revokimin e tij miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.*

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente për "Sistemi i Menaxhimit të Cilesisë". Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH. Certifikata të jetë e përkthyer dhe noterizuara në gjuhën shqipe.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se mallrat objekt prokurimi plotesojnë kërkesat e cilesisë, duke qene se kjo certifikate është certifikata me e njohur ndërkombetare për standartin e menaxhimit të cilesisë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata ISO 13485:2016 ose ekuivalente e prodhuesit. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH. Certifikata të jetë e përkthyer dhe noterizuara në gjuhën shqipe.

Për rastet kur OE nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e një vetëdeklarimi me shkrim, që në këtë rast, furnizuesi është konform standardeve të cilësisë. AK ruan të drejtën e verifikimit të vetëdeklarimit. AK ka të drejtë të kërkojë paraqitjen e certifikatës në fjalë nëse OE shpallet fitues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

ISO 13485: 2016 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë për OE të përfshirë në një ose më shumë faza të ciklit jetësor të një pajisjeje mjekësore. Kjo certificate siguron bazën për të siguruar dizajn, zhvillim, prodhim, instalim dhe shpërndarje të qëndrueshme të produkteve që të jene të sigurt për qëllimin e synuar. ISO 13485 është një standard i harmonizuar i zbatuar nga prodhuesit e pajisjeve mjekësore për të vërtetuar përputhshmërinë e sistemit të cilësisë me kërkesat e Direktivës 93/42/EEC.

Për rastet kur OE nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e një vetëdeklarimi me shkrim, që në këtë rast, furnizuesi është konform standardeve të cilësisë. AK ruan të drejtën e verifikimit të vetëdeklarimit. AK ka të drejtë të kërkojë paraqitjen e certifikatës në fjalë nëse OE shpallet fitues.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën CE ose Deklaratë Konformiteti sipas direktives 93/42/ EEC ose certifikatën FDA për produktet e ofruara, që vërteton se arikujt objekt prokurimi janë prodhim evropian.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Direktiva e Pajisjeve Mjekësore (93/42/EEC) përcakton që prodhuesit e pajisjeve mjekësore duhet t'i etiketojnë produktet e tyre me shenja CE para se t'i hedhin në tregun e BE -së

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se mallrat objekt prokurimi plotësojnë kërkesat e cilesise se pajisjeve mjekësore, si dhe te jene te markuara CE per efekt sigurie, besueshmerie, per shkak te perdorimit te mallrave objekt prokurimi (qe perdoren ne sherbimin e urgjences, per qytetaret te ndodhur ne kushte rreziku per jeten).

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate mbi origjinen e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) per secilin artikull, per plotësimin e afatit te skadences se tyre, per përmbushjen e sasise te kërkuara, si dhe respektimit te specifikimeve teknike te kërkuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 3 dhe 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ky kriter eshte vendosur per te krijuar bindjen te AK se mallrat qe do te furnizohen nga OE do te jene sipas kerkesave te cilesise, origjines, skadences dhe specifikimeve (pasi mallrat objekt prokurimi do te perdoren per sherbimin e urgjences mjekësore, per qytetaret te ndodhur ne kushte rreziku per jeten).

2.3.8 Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuar, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollshme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te përcaktuar ne formularin e ofertes

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, germa b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

*Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë; (per te pare te pershkruar specifikimet teknike te mallrave objekt prokurimi nese perputhen me kerkesat e AK)*

2.3.9 Për artikujt e ofertuar duhet të paraqiten mostra në ditën dhe orën e hapjes së ofertave. Dorezimi i kampioneve/mostrave, të bëhet pranë Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse-

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet:

- *“Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « Blerje set urgjence » dhe jo para datës 19.09.2022, ora 11:00*
- *Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.*
- *Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet te shënojë nr.rendor të artikullit që përfaqëson sipas formularit të çmimit.*
- *Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit, e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.*

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas nr. rendor të formularit të çmimit, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçante ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, germa a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

*Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit*

Kërkesa për mostra është bërë marrë parasysh rëndësinë e veçantë të shërbimit për të cilin do të përdoren mallrat objekt prokurimi, që është për shërbimin e urgjencës mjekësore. Për këto artikuj duhet patjetër një vlerësim fizik i tyre përpara se të lidhet kontrata me OE, për tu siguruar që këto mallra janë sipas specifikimeve të vendosura nga AK.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Per shkak te kerkesave te vazhdueshme te sherbimit te urgjences mjekesore, i cili eshte nje sherbim i pandreprete 24 h/7 dite te javes, per gatishmerine e ekipeve te urgjences mjekesore ne terren, eshte e domosdoshme blerja e mallrave te konsumit, marre parasysh edhe buxhetin e vene ne dispozicion, si ne vijim:

Nr	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
1	Imobilizues bacini	cope	8
2	Set imobilizimi gjymtyresh – Splinte, kit me 5 pjesë, me cante mbajtëse	cope	5
3	Mandrino (Tel i ngurtë, i veshur, i cili futet ne tubon endotrakeale te tij, per orientim ne intubim)	cope	10
4	Spider-set imobilizimi ne forme merimange	cope	20
5	Qafore 3 masa	cope	1200
6	Bllokues koke	cope	8
7	Set imobilizimi kolone	cope	7
8	Mbulese izotermike(metalin)	cope	300
9	Çanta autoambulances, te kete dhe Setin e vogël	cope	4
10	Strisha glukometri	cope	16000
11	Glukometer	cope	40
12	Gudel	cope	20
13	Rakord O2	cope	30
14	Maske silikoni	cope	30



15	Maske aerezoli	cope	20
16	Ambu	cope	10
17	Sfigmomanometër	cope	40
18	Fonendoskop	cope	40
19	Termometër	cope	40
20	Leter EKG	cope	150
21	Ngjitese per elektrodat	cope	10000
22	Fasho autoadezivë 10 x 20	cope	50
23	Fasho autoadezive 10x15	cope	50
24	Fasho autoadezive 10x10	cope	50
25	Çarçaf njëpërdorimësh	cope	5000
26	Lak hemostatik	cope	100
27	Kanjula venoza 18.20	cope	2000
28	Garza Pambuku	kilogram	15
29	Paketa dizifektuese (alkol, betadine dhe uje i oksigjenuar)	cope	20
30	Bisturi 1 përdorimësh	cope	5
31	Gërshërë të vogla	cope	10
32	Pulsoksimeter	cope	40
33	Maske oksigjeni me rezervuar	cope	2000
34	Tub nazal per oksigjenin	cope	2000
35	Mushama (Telo)	cope	40
36	Piastra adulte te perputhshme me Defibrilator Primedic	cope	3
37	Piastra adulte te perputhshme me Defibrilator Rescue Life	cope	3
38	Piastra Pediatrike te perputhshme me Defibrilator Primedic	cope	2
39	Piastra Pediatrike te perputhshme me Defibrilator Rescue Life	cope	2
40	Doreza njeperdorimshme	cope	10000
41	Bateri Defibrilatori te perputhshme me Defibrilator Rescue Life	cope	2
42	Bateri Defibrilatori te perputhshme me Defibrilator Primedic	cope	2
43	Bateri Defibrilatori te perputhshme me Defibrilator AED Rescue Life Sam	cope	2
44	Kabell (ECG 5 kanale) te perputhshme me Defibrilator Rescue Life	cope	2

45	Kabell (ECG 12 kanale) te perputhshme me Defibrilator Primedic	cope	2
46	Kabell (SPO2) te perputhshme me Defibrilator Rescue Life	cope	5
47	Kabell + Manshet(NIPB) te perputhshme me Defibrilator Rescue Life	cope	8
48	Tournique	cope	10
49	Doreze Laringoskopi	cope	2
50	Lama	cope	6
51	Tubo(ET)	cope	10
52	Sonde aspirimi	cope	7
53	Sonde nazogastrike	cope	2
54	Kateter vezikal 2 rugesh 16.18	cope	10
55	Qese urine	cope	10
56	Shiringa 20 cc	cope	500
57	Shiringa 10 cc	cope	1500
58	Shiringa 5 cc	cope	1500
59	Lancet	cope	600
60	Chlorhexidin	cope	10
61	Sisteme infuzioni	cope	200
62	Maska laringale PVC	cope	1
63	Maska laringale silikoni	cope	1
64	Doreza sterile	cope	10
65	Piastra Manulae Permanente te perputhshme me Defibrilator Rescue Life	cope	8
66	Shiringe Intrakockore per urgjencen	cope	2
67	Imobilizues kolone alumini	cope	8
68	Kanjule nazofaringeale	cope	25

## 1. IMOBILIZUES BACINI (PELVIK)



- Është disapërdorimeshe në formë rrethore e cila bllokun baçinin në mënyrë simetrike. Ajo ndalon hemorragjinë e baçinit kur ka fraktura të tij në trauma. Bllkohet nëpërmjet një sistemi me rrip të fortë që kalon nëpërmjet një tokëze/unaze, që lejon përshtatjen e mbylljes me ngjitje me velkro, sipas diametrit të bacinit të pacientit.
- Radio transparent për radiologjinë, material i padeformuëshëm, mund të dezinfektohet dhe dekontaminohet për shumë përdorime, rrip të jetë i përthyeshëm dhe elastik.
- Të jetë i përshtatshëm për mosha të ndryshme.

### ARGUMENTIMI:

- E domosdoshme dhe jetëshpëtuese për traumat pelvike me hemorragji masive.
- Garanton imobilizimin e frakturave dhe ndalimin e hemorragjisë. Rripat siguroes dhe tokëza/unaza garantojnë përdorimin e tij për mosha të ndryshme.
- Është radiotransparente në mënyrë që të mos ndërferojë me radiologjinë gjë e cila lejon bërjen e ekzaminimeve të bë tilla pa e hequr atë nga fraktura.

## 2. SET IMOBILIZIMI PËR GJYMTYRËT (SPLINT)



Sistem për imobilizimin e gjymtyrëve në rastet e frakturave të gjymtyrëve të sipërm dhe të poshtëm, te të rriturit dhe fëmijët.

Mbyllja me shirita me ngjitje.

Bordurat të jenë me qepje ose ngjitje që sigurojnë qëndrueshmëri.

Materiali Neopren, (familja e gomës), Alumin, i veshur në pjesën e brendshme dhe të jashtme me nylon laminat.

Material shumë rezistent, 100% kundër lëgështirës, i cili është i lehtë për t'u pastruar.

I përbërë nga 5 pjesë:

1. Për imobilizimin e frakturave të pulsit
3. Për imobilizimin e parakrahut të të rriturit dhe të gjymtyrëve të poshtëm të fëmijës
4. Për imobilizimin e kavigjës, bërrylit ose si bllokues krahu gjatë infuzionit venoz
5. Për imobilizimin e gjymtyrëve të sipërm të të rriturit ose të gjymtyrëve të poshtëm të fëmijëve
6. Për imobilizimin e gjymtyrëve të poshtëm të të rriturit.

E pajisur me çantë për vendosjen e setit.

#### **ARGUMENTIMI:**

- E domosdoshme sepse garanton pozicionimin dhe imobilizimin e frakturave të gjymtyrëve.
- Shiritat sigurojnë për të fiksimit sigurojnë mbajtjen drejt të gjymtyrës së frakturuar te pacientit. Materiali Neopren, (familja e gomës), Alumin, i veshur në pjesën e brendshme dhe të jashtme me nylon laminat për është garanci në funksion dhe jetegjatesi të paisjes.
- 5 pjesë të përmasave të ndryshme sigurojnë të gjitha frakturat për të gjitha moshat.

### **3. MANDRINO**



- Është një tel alumini, i përthyeshëm, që merr formë, i veshur, i cili futet ne tubon endotrakeale te tij, per orientim ne intubime të vështira, si: qafa e shkurtër, korda vokale të padukshme, goja e vogël etj.

**ARGUMENTIMI:**

- E domosdoshme per intubimin ne raste te veshtira qe nuk mund te realizohen me metodat standarte

**4. SET IMOBILIZIMI NË FORMË MERIMANGE -SPIDER**



- Të mundësojë një fiksion të shpejtë të të dëmtuarit në barrelë, pa dëmtime të strukturave anatomike,
- Një imobilizim korrekt të kolonës dhe artikulacioneve, edhe në transporte të gjata e në kushtë të vështira,
- Rripat e ndërtuar nga material elastik dhe shumë i qëndrueshëm kanë në pjesën fundore të tyre ngjitëse që mundësojnë fiksionin e sigurt në barrelë dhe njëkohësisht mundësojnë shkëputjen e lehtë prej saj, në momentin e heqjes së spiderit.

**ARGUMENTIMI:**

- E domosdoshme per fiksionin e pacientit dhe transportin e tij.
- Duhet te kete rripat sigurues me material elastik per zgjatjen dhe per garancine e fiksimit te pacientit dhe me velkro për përdorim të shpejtë dhe sigurues.

**5. QAFORE (Blokues i kolonës cervikale)**



- Të jetë me përmasat jo më pak se 30x30 cm
- Duhet të garantojë gjatë lëvizjes së të dëmtuarit një linearizim sipas aksit anatomik dhe shtrirje të sigurt të vertebrave cervikale .
- Duhet të sigurojë një kontroll të mirë të lëvizjeve aksiale dhe përkuljeve laterale të kolonës
- Struktura themelore të jetë e realizuar me material polietilieni me densitet të ulët, që siguron pastrim të lehtë. Cdo njollë gjaku dhe yndyre mund të hiqet me lehtësi dhe shpejtësi
- Të jetë fleksibël për të përmirësuar aplikimin, dhe e ngurtë për të përmirësuar imobilizimin.
- Të ketë një hapje të përparme për të lehtësuar aksesin e trakeotomisë.
- Mund të jetë e përbërë nga një pjesë e vetme ose dy pjesë që lidhen me velkro me ngjitje.
- Fiksimi bëhet me velkro me ngjitje.
- Të jetë në 3 masa

#### **ARGUMENTIMI:**

- E domosdoshme për imobilizimin e kolonës cervikale në trauma.
- Permasa me dimensione të ndryshme për të mbuluar një game sa më të gjere pacientesh
- Të jetë fleksibël dhe me nje hapje të përparme për të përmirësuar aplikimin, dhe e ngurtë për të përmirësuar imobilizimin dhe për të lehtësuar aksesin e trakeotomisë. Velkro për nje ngjitje të shpejte dhe të kontrolluar.

#### **6. BLOKUES KOKE**



- Të jetë e përbërë nga material sfungjeri me densitet të lartë dhe nga jashë e mbuluar me veshje hidrorezistente
- Të parandalojë çdo lëvizje të kokës së të dëmtuarit gjatë transporti

#### **ARGUMENTIMI:**

- E domosdoshme per imobilizimin e kokes dhe kollonës në trauma të ndryshme.
